



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:023997

Datë: 09.07.2020

Numri i dokumentit: 01016906

PKR.nr.100/2020

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,- Departamenti për Krime te Renda, gjykatësi Shaqir Zika, me pjesëmarrjen e sekretarit juridik Bute Ramosaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit N.D. nga K- Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 prg 1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, - Departamenti për Krime te Renda PP/I.nr. 42/2020, të dt. 28.05.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt. 30.06.2020, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarit N.D si dhe mbrojtësit të tij av. Azem Islamaj, i caktuar sipas detyrës zyrtare, ekspertit të psikiatrisë të Institutit Forenzikë Psikiatrisë në Prishtinë dr. SH.H me dt. 30.06.2020, muar dhe shpall në ndërsa me dt. 09.07.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.D., nga i ati M., dhe ëma L., e gjinisë N., data e lindjes... në Gjakovë, tani me banim në fshatin.... K- Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme i pa martuar i pa punë, Shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës, me numër personale ...

Ë S H T Ë F A J T O R

Pasi me parë ka siguruar e gjere me dt. 13.01.2020 rreth orës 11:18 minuta, në rrugë..., saktësisht para Stacionit Policor pa autorizim ka poseduar armë në kundër shtim me nenin 4 prg 1 nën prg 1.1 të Ligjit për armët të Republikës së Kosovës, Nr. /05/L - 022, të cilat me Ligj kategorizohen si armë të ndaluara, dhe atë një thikë 26 cm, e gjatë, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri merr thikën të cilën e vendos në brez shkon në Stacioni Policor të porta e hyrjes pas ndalet nga zyrtaret policor pyetet se çfarë kërkon, i pandehuri ju përgjigjet se “ i kam disa pune me sqaruar me D.SH dhe kur skam të ja harroi D., dhe ekipit të tij se çfarë me kane ba”, pasi arrestohet nga Policia gjate kontrollit në Trupin e të pandehurit saktësisht në brez i gjene thikën të cilën me pas është sekuestruar nga ana e zyrtareve policor.

-me çka ka kryer vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim të autorizuar të armëve nga neni 366 prg 1 të KPRK-se,

Gjykata në kuptim të dispozitës së neneve 2, 4, 6, 18 prg 2, 46, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 366, te KPRK-se, dhe neni 365 te KPPK-se, të pandehurit i **shqipton**:

DENIMIN ME KUSHT

Ashtu qe te pandehurit N.D. i caktohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri ne afat prej 2 (dy) viteve nga data kur ky aktgjykim te behet i formës së prere, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Konfiskohet ne mënyrë te përhershme thika e përshkruar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, komform nenit 366 prg 3 te KPRK-se.

I akuzuari obligohet qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 50€, si dhe ne emër te programit për kompozimin e viktimave te krimit shumen prej 50€, te gjitha këto ne afat prej 15 ditëve pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prere, nen kërcenim te përmbarimit me dhunë.

Gjykata komform dispozitave te nenit 18, 83, 84 prg 1 pika 1.2 , 85, 86, te Kodit Penal si dhe nenit 513 dhe 515 te Kodit te Procedurës Penale, te akuzuarit krahas dënimit te shqiptuar si me lartë i shqiptohet dhe

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË LIRI NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSORE PRANE QENDRES SE SHËNDETIT MENDOR NË GJAKOVË

I. Obligohet i akuzuari N.D. nga K- Gjakove, qe ti nënshtrohet trajtimit te detyrueshme psikiatrik ne liri, do te paraqitet ne Qendrën e Shëndetit Mendor ne Gjakovë, sipas kohës, terminëve, dhe rekomandimeve te mjekteve - eksperteve, te psikiatrisë, gjithashtu te përdor terapinë sipas rekomandimit te eksperteve.

II. Kjo masë do te ekzekutohet ne Institucionin e kujdesit shëndetësore ne Qendrën e Shëndetit Mendor ne Gjakovë, e cila obligohet qe te pranoi te akuzuarin N.D. për trajtim te detyruar psikiatrik ne liri, dhe kohe pas kohe te njoftoi Gjykatën mbi gjendjen dhe suksesin e trajtimit te tij, dhe atë se paku një here ne 6 (gjashtë) muaj, si dhe te njoftoi Gjykatën për çdo vështirësi ne trajtim.

III. Masa e trajtimit te detyruar Psikiatrik në Liri, nuk është e kufizuar ne kohë. Kjo masë do te zgjas për aq kohe sa i akuzuari N.D. do te ketë nevojë për trajtim e deri sa te ekzistojnë kushte mbi te cilat është caktuar kjo masë, por jo me tepër se tri vite.

IV. Në rast te mos respektimit te kësaj mase nga i akuzuari, Gjykata mund te vendos për ndërrimin e masës - shqiptimit te masës së trajtimit te detyruar psikiatrike me ndalim.

V. Kjo masë është caktuar – shqiptuar pasi qe i akuzuari është diagnostikuar me ç rregullim akut psiko tik qe ne klasifikimin ndërkombëtar te sëmundjeve ICD 10, kodohet me shifrën F-23.8, si dhe ç rregullim mendor i sjelle si pasojë e përdorimit te substancave psiko aktive F-12.0 (ICD-10).

Obligohet Shërbimi Sprovues i Kosovës Zyra Rajonale ne Gjakovë, qe te beje raport periodik për zbatimin e masës së trajtimit te detyrueshëm psikiatrike ne liri.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime te Renda, Gjykatës Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime të Rënda, i ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr. 42/2020, te dt. 28.05.2020, kundër te akuzuarit N.D. nga K- Gjakovë, për shkak te veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 30.06.2020, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, i akuzuari N.D. si dhe mbrojtësi i tij av. Azem Islamaj i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në fillim te seancës përfaqësuesi i akuzës ka deklaruar se gjate përpilimit te aktakuzës ka bërë një gabim teknik ku i ka propozuar Gjykatës qe krahas dënimit te akuzuarit ti shqiptohet dhe masa e trajtimit detyrueshëm psikiatrik ne liri ne Institucionin e Shëndetit Mendor ne Gjakovë, e jo siç është cekur ne aktakuze Masa e Trajtimit te Detyrueshëm Psikiatrik me Ndalim, ne Institucionin e Kujdesit Shëndetësor.

Gjykata ne seancë ka ftuar ekspertin e psikiatrisë dr. SH.H. nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike ne Prishtinë qe para shqyrtimit fillestar i njëjti te deklarohet se i akuzuari a është ne gjendje ti nënshtrohet gjykimit, ku pas bisedës se shkurtër me te pandehurin N.D. eksperti i psikiatrisë Dr. SH.H. ka deklaruar se i akuzuari është ne gjendje te merr pjesë ne gjykim, dhe është ne gjendje te përcjelle shqyrtimin gjyqësore.

Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala, gjate shqyrtimit fillestar te mbajtur me 30.06.2020, lexoi aktakuzën PP.nr. 42/2020, te dt. 28.05.2020, dhe deklaroi se mbetem ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari N.D. gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se ne mënyrë vullnetare, pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij duke ditur qe me parë për pasojat e pranimit fajësisë dhe favoret e pranimit ka deklaruar se e pranon fajësinë për vepër penale për te cilën akuzohet duke theksuar se i vjen keq për rastin ka shprehur pendesën e thelle, dhe ka premtuar qe ne te ardhmen nuk do te kryen vepra te tilla apo te ngjashme penale.

Mbrojtësi i te akuzuarit N.D. av. Azem Islamaj, ka deklaruar se pas konsultimeve te mjaftueshme me te mbrojturin tim te njëjtit i ka shpjeguar për te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë, i njëjti është deklaruar i fajshëm për vepër penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e ka bere ne mënyre te vullnetshme i njëjti nuk ka qene i kërcënuar apo i vene ne lajthim andaj i propozon Gjykatës qe te aprovoi pranimin e fajësisë se te akuzuarit, dhe gjate shqiptimit te dënimit Gjykata te kete parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë i njëjti ka bashkëpunuar me Organet e Ndjekjes kërkim falje te tij, është i moshës se re, me herët nuk ka qene i dënuar, ndërsa sa i përket masës se propozuar mendoi se i njëjti te njëjtën masë do te respektoi edhe do te ndikoi pozitivisht ne risocializimin e tij.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, pas deklarimit te akuzuarit dhe mbrojtësit te tij ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së te akuzuarit pasi qe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, i njëjti është konsultuar mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe pas marrjes se mendimit nga ana e psikiatrit Dr. SH.H. mbi gjendjen e tij ku i njëjti

ka deklaruar se i njëjti mund të përcjelle gjykimin ka kuptuar aktakuzën, pranimin e fajësisë e ka bere me vete dije dhe vullnet të plote dhe pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova ne të cilën është ngritur aktakuza.

Po ashtu të njëjti të shqiptohet masa e trajtimit detyrueshëm psikiatrik në Liri, pasi që llogaritsh mëria e tij ka qene esencialisht e zvogëluar dhe atë në bazë të ekspertizës së kryer nga Instituti Psikiatrike Forenzike në Prishtinë, ku nga mendimi i eksperteve i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qene në gjendjen të aftësisë së zvogëluar mendore të shkalles esenciale, dhe se i njëjti ka çrregullim akut psikotik të sëmundjeve ICD-10. Andaj i ka propozuar Gjykatës që në kuptim të nenit 18 prg 2 lidhur me nenin 85 prg 1 pika 1.2 dhe nenit 515 të pandehurit të shqiptohet Masa e Trajtimit të Detyrueshme Psikiatrik në Liri.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, Gjykata ka vërtetuar se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 prg 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Kodit Procedurës Penale të R. Kosovës, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare, nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështet në fakte të çështjes që përmban aktakuza. Po ashtu ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte Ligjore ose gabime faktike, dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës apo të pushimit të procedurës penale të parapare me nenin 253 prg 1 të KPPK-se. Andaj Gjykata ka pranuar këtë pranim të fajësisë.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u mbështetur jo vetëm nga pranimi i fajësisë që është bere nga i akuzuari, por ky pranim ka mbështetje edhe në prova që gjenden në shkresat e lëndës, për çka dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor.

Nga raporti mbi gjendjen shëndetësore të Institutit Psikiatrike në Prishtinë për të akuzuarin N.D. me numër të protokollit 98-/2 të dt. 05.05.2020, është konstatuar, gjatë ekzaminimit psikiatrik ambulator në Institutin e Psikiatrikë Forenzike në Prishtinë, pas dokumentacionit mjekësor që kanë qene në shkresat e lëndës kemi bere dhe ekzaminimin e tij direkt me ç rast kemi vërejtur se i njëjti ka ç rregullime të përkohshme mendore i cili quhet ç rregullim akut psikotik dhe kodohet me shifrën F-23.3, të njëjti kjo simptomatologji është paraqitur si pasoje e përdorimit të me hershme të substancave psikotrope- marihuana si pasoje e kësaj ka ardhur deri të ç rregullimin mendor, i sjelle si pasoje e përdorimit të këtyre substancave që të i akuzuari ka pasur dëmtime në sferën kognitive, posaçërisht kemi të beje me dëmtime të menduarit, precipcionit emocioneve vëmendjes dhe koncentrimin. Duke qene se kjo është fazë kalimtare rekomandimi im është që i njëjti të trajtohet dhe të përcjellët në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë, apo në ndonjë Institucion tjetër Shëndetësor.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-se, si rrethanë lehtësuese Gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar, shkallen e përgjegjësisë penale, tek i akuzuari ka qene e zvogëluar shkalla esenciale, mosha e re e tij, me herët nuk ka qene i gjykuar, ka premtuar se në të ardhëm nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, andaj Gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin alternativë, dënimin me kusht me shprese dhe bindje se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i parapare me dispozitat e nenit 47 të KPRK-se, i cili konsiston me parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij, të parandaloi personat tjera nga kryerja e veprave

penale, dhe te shpreh gjykimin shoqërorë për veprë penale ngritjen e morale dhe forcimit të respektimit të ligjit.

Gjykata krahas dënimit të shqiptuar kundër të akuzuarit, ka shqiptuar dhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor pranë Qendrës së Shëndetit Mendor, duke u bazuar në dispozitat e nenit 86 prg 1 lidhur me prg 4 të KPRK-se, lidhur me nenin 515 prg 1 të KPPK-se, për e cilën Gjykata është e bindur se do të ndikoi pozitivisht tek i njëjti me qëllim të trajtimit të tij shëndetësor psikiatrik, e këtë duke u bazuar në personalitetin e të akuzuarit dhe gjetjen e lidhur me gjendjen e shëndetit mendore të tij, të bere në raportin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.

Gjykata vlerëson se Masa e Trajtimit të Detyrueshëm në liri, për të njëjtin është e nevojshme jo vetëm për të shmangur rrezikun serioz se mund të kryej serish veprë penale por edhe me qëllim të trajtimit dhe mjekimit të tij, ndaj të njëjtit i shqiptuar Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, me detyrim që i njëjti të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor sipas kohës, terminëve dhe rekomandimeve të mjekëve ekspert të psikiatrisë, gjithashtu të përdor terapinë sipas rekomandimeve të eksperteve në kohëzgjatje gjersa të jete e nevojshëm për zëvendësimin e kësaj mase, por jo me gjatë se tri vite nga dita e shqiptimit të kësaj mase, me detyrim që Qendra e Shëndetit Mendore se paku një here në gjashtë muaj të njoftoi Gjykatën për gjendjen e tij shëndetësorë dhe suksesin e trajtimit.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallin gjyqësor është marrë komform nënti 450 prg 1 dhe 2 nën prg 2.6 lidhur me nenin 453 prg 1 të KPPK-se, ndërsa për programin dhe kompozimin e viktimave të krimit është marrë komform nënti 39 prg 3 nën prg 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036, për kompozimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE,-Departamenti për Krime të Renda
PKR.nr.100/2020, dt. 09.07.2020.**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i Trupit Gjykuese
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve, nga data e pranimit të tij, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.